

BEST SCENARIO
NYC HEALTH + HOSPITALS PREZANTON
PARANDALO GRIPIN
QË PO TË VJEN RROTULL



**NYC
HEALTH+
HOSPITALS**

GENERAL AUDIENCES
ALL AGES ADMITTED

★★★★★
MJEKU JUAJ

★★★★★
PERSONI PRANË JUSH NË METRO

★★★★★
FAMILIA JUAJ

VAKSINOHUNI KUNDËR GRIPIT SOT!

Vizitoni zyrën e mjekut tuaj ose na telefononi për të caktuar një takim.

1-844-NYC-4NYC (1-844-692-4692)

Vaksina kundër gripit – Pyetje të bëra shpesh

Kush duhet të vaksinohet kundër gripit?

- + Të gjithë njujorkezët e moshës 6 muaj e lart duhet ta bëjnë vaksinën, por sidomos:*
- + Fëmijët më të vegjël se 5 vjeç
- + Të rriturit mbi 50 vjeç
- + Gratë shtatzëna dhe ato pas lindjes
- + Njerëzit me sëmundje kronike, si diabeti, astma, HIV, mbipesha, sëmundjet e veshkave dhe të zemrës
- + Rezidentët dhe stafi i azileve të pleqve ose i institucioneve të kujdesit afatgjatë
- + Të gjithë punonjësit e shërbimeve bazë, sidomos punonjësit shëndetësorë

Përse është kaq e rëndësishme ta bëni vaksinën e gripit sivjet?

- + Mund të bëni dhe vaksinën e gripit dhe të COVID-19.
- + Vaksina kundër gripit parandalon miliona sëmundje dhe vizitat te mjeku në lidhje me gripin çdo vit. Gjatë sezonit të gripit 2023-2024, gripi shkaktoi rreth 40 milionë sëmundje të gripit, 470,000 shtrime në spital për shkak të gripit dhe 28,000 vdekje nga gripi.
- + Gripi dhe COVID-19 shkaktohen nga viruse të ndryshme. Prandaj, megjithëse vaksina kundër gripit nuk parandalon COVID-19, ajo ul rrezikun e shtuar të sëmundjeve nga gripi, shtrimeve në spital dhe vdekjeve në komunitetin tonë, si dhe ndikimin në sistemin e kujdesit shëndetësor.

Cila është mënyra më e mirë për të mbrojtur veten dhe të tjerët nga gripi dhe nga sëmundjet e tjera të frymëmarrjes?

- + Bëni vaksinën e re të gripit dhe vaksinën e re të COVID-19 në çdo sezon të viruseve të rrugëve të frymëmarrjes
- + Lajini dhe dezinfektojeni mirë dhe rregullisht duart
- + Praktikoni etiketën e frymëmarrjes – mbuloni gojën kur kolliteni dhe teshtini
- + Shmangni prekjen e syve, hundës dhe gojës
- + Shmangni kontaktin e ngushtë me personat e sëmurë
- + Përdorni maskë cilësore kur jeni në vende me njerëz ose të mbyllura me njerëz që nuk i njihni dhe sigurohuni që maska të mbulojë gojën dhe hundën.
- + Nëse ndiheni keq, qëndroni në shtëpi dhe kontaktoni mjekun tuaj kryesor ose bisedoni me një ofrues të ExpressCare virtual duke vizituar ExpressCare.nyc ose duke telefonuar në numrin 631-397-2273.
- + Nëse ndiheni keq, bëni testin për gripin dhe COVID-19

A mund ta bëni vaksinën kundër gripit njëherësh me vaksinën kundër COVID-19?

Po. Ju mund të bëni vaksinën kundër gripit në të njëjtën kohë me vaksinat e tjera, përfshirë vaksinën kundër COVID-19, dhe, nëse kualifikoheni, vaksinën kundër Virusi sincial respirator (Respiratory Syncytial Virus, RSV).

Gripi

- + Një infeksion i rrugëve të frymëmarrjes i shkaktuar nga virusi i gripit
- + Transmetimi ndodh përmes cërkave të frymëmarrjes, aerosoleve dhe kontaktit me sipërfaqet e kontaminuara.
- + Shumica e njerëzve me grip janë transmetues afërsisht 1 ditë para fillimit të simptomave deri në 5-7 ditë pas fillimit të simptomave.
- + Mund të trajtohet me mjekime antivirale të miratuara nga Administrata e Ushqimit dhe Barnave (Food and Drug Administration, FDA) që luftojnë virusin e gripit

COVID-19

- + Një infeksion i rrugëve të frymëmarrjes i shkaktuar nga një koronavirus, i quajtur SARS-CoV-2
- + Mund të jetë më ngjithës se gripi
- + Transmetimi ndodh përmes cërkave të frymëmarrjes dhe aerosoleve
- + Simptomat e COVID-19 zakonisht fillojnë rreth 4-5 ditë pas ekspozimit ndaj virusit
- + Mund të shkaktojë sindromën inflamatore multi-sistem te fëmijët
- + Mund të shkaktojë efekte anësore afatgjata, të quajtura "COVID i gjatë", të cilat përfshijnë një sërë simptomash që mund të zgjasin për javë apo muaj pas infektimit
- + Mund të trajtohet me mjekime antivirale të miratuara nga FDA

Të dyja

- + Mbivendosje e simptomave, duke përfshirë: ethe, të dridhura, kollë, gulçim, vështirësi në frymëmarrje, lodhje, dhimbje fyti, rrjedhje nga hunda dhe bllokim hunde, dhimbje muskujsh, dhimbje trupi, dhimbje koke, të vjella, diarre
- + Si vaksina kundër gripit ashtu edhe ajo kundër COVID-19 mund të parandalojnë dhe zvogëlojnë rrezikun që të prekeni nga sëmundje të rënda.

Vaksinat kundër gripit janë të sigurta, të shpejta dhe ofrohen pa shpenzim nga ana e pacientëve të cilët vaksinohen në një prej pikave tona të dedikuara të vaksinimit. Vaksinohuni kundër gripit sot!

Vizitoni nychealthandhospitals.org ose telefononi **1-844-NYC-4NYC** (1-844-692-4692) për të gjetur një pikë pranë jush.